


PROGRAMI I PUNËS SË KDIMDP-së
JANAR – DHJETOR 2019



**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
 E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
 E TË DHËNAVE PERSONALE**

MIRATOI

KOMISIONERI

Besnik Dervishi



ZYRA E KOMISIONERIT

OBJEKTIVI	MASAT E PËRGJITHSHME	PERIUDHA	REZULTATI
Hartimi i Raportit Vjetor 2018 mbi veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit.	Hartimi i draft - raportit; Koordinim i brendshëm institucional me qëllim mbledhjen e informacioneve/statistikave në lidhje me performancën vjetore institucionale.	Janar 2019.	Raporti Vjetor 2018 i miratuar. Dërgimi në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.
Zhvillimi i Konferencës së 41-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë 21-24 tetor 2019.	Hartimi i planit të masave për organizimin e Konferencës Ndërkombëtare dhe monitorimi në vijimësi i zbatimit të tij në bashkëpunim me Komitetin Ekzekutiv; Përgatitja dhe mirëmbajtja e faqes së dedikuar në internet; Përgatitja dhe mirëmbajtja e aplikacionit të dedikuar në internet; Bashkërendimi i punës për përgatitjen dhe monitorimin e zbatimit të aspekteve logjistike të Konferencës Ndërkombëtare;	Janar- Tetor 2019.	Aktivitet/Konferencë me standarde të larta.

	<p>Raportim periodik dhe takime me Komitetin Ekzekutiv, bashkëpunim për përgatitjen e programit përkatës për çdo seksion.</p> <p>Bashkërendimi i punës për bashkë - hartimin e dokumenteve /rezolutave/deklaratave të Konferencës Ndërkombëtare.</p> <p>Zhvillimi i Konferencës dhe të gjitha aktiviteteve në lidhje me të.</p> <p>Përmbyllja e të gjitha aspekteve <i>ex post</i>, përfshirë finalizimin e dokumenteve, përgatitjen e raporteve, materialeve informuese, etj.</p>	<p>Tetor 2019.</p> <p>Tetor-Dhjetor 2019.</p>	
<p>Zbatimi i projektit IPA II 2017 (Standart Twinning) sipas aktivitetit “Ndërtimi i institucioneve për harmonizimin me <i>acquis</i> të BE-së për të përmbushur kriteret ekonomike lidhur me mbrojtjen e të dhënave.</p>	<p>Analizimin dhe krahasimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor shqiptar në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.</p> <p>Trajnim i stafit të Zyrës së Komisionerit mbi risitë e Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave të BE-së (GDPR).</p> <p>Asistencë në hartimin e legjislacionit të ri shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave të BE-së.</p> <p>Asistencë në hartimin e kuadrit nënligjor të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, i ndryshuar, etj.</p>	<p>Gjatë vitit.</p>	<p>Legjislacioni kombëtar i mbrojtjes së të dhënave personale i harmonizuar me Rregulloren e BE-së 679/2016 dhe Direktivën e BE-së 680/2016.</p>

E DREJTA E INFORMIMIT

OBJEKTIVI	MASAT E PËRGJITHSHME	PERIUDHA	PRODUKTI
<p>Monitorimi dhe mbikëqyrja e ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.</p> <p>Rritja e numrit të masave administrative për shkelje ligjore të konstatuara, me fokus të veçantë mungesën e programeve të transparencës dhe regjistrimit të kërkesave dhe përgjigjeve.</p>	<p>Kontrolli periodik i programeve të transparencës së Autoriteteve Publike.</p> <p>Shqyrtimi i ankesave.</p> <p>Ushtrim i hetimeve administrative.</p> <p>Organizimi i seancave dëgjimore.</p>	Gjatë vitit.	<p>Program Transparence për A.P.</p> <p>Kthim/Përgjigje.</p> <p>Masa administrative.</p> <p>Vendime.</p> <p>Raporte.</p> <p>Raport monitorimi.</p>
<p>Përfshirja për të pasur rol aktiv në rregullimin e veprimtarisë së medias <i>online</i>, duke siguruar informacion publik proaktiv nga autoritetet publike, në respekt dhe garantim të parimeve dhe legjislacionit për privatësinë.</p>	<p>Ndërgjegjësimi i medias <i>online</i> mbi të drejtat dhe detyrimet që parashikon legjislacioni në fuqi në kompetencë të Zyrës së Komisionerit.</p>	Gjatë vitit.	<p>Media <i>online</i> e ndërgjegjësuar.</p>
<p>Monitorimi i përditësimit të programeve të transparencës dhe regjistrimit të kërkesave dhe përgjigjeve, nga autoritetet publike, me fokus të veçantë ministrinë dhe organet e pushtetit vendor.</p>	<p>Kontroll periodik i programeve të transparencës së ministrive dhe organeve të pushtetit vendor.</p>	Gjatë vitit.	<p>Program Transparence të përditësuar për ministrinë</p> <p>Rekomandime për organet e pushtetit vendor.</p>

	Kontroll periodik i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve së ministrive dhe organeve të pushtetit vendor.		
Fushatë ndërgjegjësuese në Administratën Publike. Rishikim i programeve të transparencës.	Pjesëmarrje në takime. Pjesëmarrje në grupe pune. Grup pune për rishikimin e programeve të transparencës.	Gjatë vitit.	Garantimi i të drejtës për informim.
Strategjia Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2015 – 2020. Objektivi: Rritja e kontrollit mbi veprimtarinë e administratës publike, garantimi i të drejtave të qytetarëve dhe aksesit në informacion.	Inspektime dhe monitorime sipas kategorive të Autoriteteve Publike. Akte shkresore. Sanksione.	Gjatë vitit.	Programe transparence të përditësuara. Kërkesa të trajtuara në përputhje me nenin 15, të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
Matja e indikatorit: Numri i ankesave të depozituara pranë Komisionerit për të drejtën e informimit në çdo vit. Numri i sanksioneve/numri i inspektimeve të kryera. Investimi për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e mëtejshme të regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit, që administrohet nga autoritetet publike.	Përditësim i regjistrit të ankesave. Përditësim i regjistrit të ankesave në portalin “Pyetshtetin.al”. Instalimi i regjistrit nga ana e autoriteteve publike.	Gjatë vitit.	Raport lidhur me indikatorin e matur. Numri i institucioneve të cilat kanë instaluar regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve.

<p>Strategjia Ndërsektorale për Antikorrupsionin.</p> <p>Përfundim i aktiviteteve të parashikuara në komponentin nr.6 të projektit të binjakëzimit antikorrupsion.</p>	<p>Vlerësim i kuadrit ligjor.</p> <p>Fushatë ndërgjegjësuere.</p>	<p>Janar - Qershor 2019.</p>	<p>Projekt/ligj “Për ripërdorimin e informacionit në sektorin publik”.</p> <p>Manual për prezantimin e rasteve të suksesit të të drejtës për informim.</p> <p>Nëpunës të trajnuar.</p> <p>Instrumenta të rinj ndërgjegjësimi.</p>
<p>Trajnimi i autoriteteve përgjegjëse në institucionet publike lidhur me detyrimet e tyre sipas ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.</p>	<p>Zhvillimi i Konferencës Kombëtare.</p> <p>Trajnimi i nëpunësve civil në periudhë prove, organizuar në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA).</p>	<p>Shtator 2019.</p> <p>Gjatë vitit.</p>	<p>Koordinatorë të trajnuar.</p> <p>Nëpunës civil të trajnuar.</p>
<p>Sensibilizimi mbi përdorimin dhe zhvillimin e regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve.</p>	<p>Fletëpalosje, postera të cilat do të vendosen në institucionet shtetërore të pushtetit qendror dhe vendor.</p> <p>Banera ndërgjegjësuere në faqet e internetit të institucioneve.</p> <p>Video të shkurtra mbi raste konkrete suksesi të zbatimi të ligjit për të drejtën për informim.</p> <p>Zhvillimi i sesione informuese në universitete publike dhe private.</p>	<p>Janar - Qershor 2019.</p>	<p>Qytetar të ndërgjegjësuar.</p>

MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

OBJEKTIVI	MASAT E PËRGJITHSHME	PERIUDHA	PRODUKTI
<p>Monitorimi dhe mbikëqyrja maksimale e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, me synim, minimizimin e shkeljeve, respektimin e privatësisë dhe përpunimin e drejtë e të ligjshëm të të dhënave personale.</p>	<p>Vlerësim i gjendjes së përgjithshme të respektimit të privatësisë nëpërmjet specifikave të fushave ku veprojnë kontrollues të ndryshëm.</p> <p>Mbajtja e kontakteve me kontrolluesit.</p> <p>Zhvillim i hetimit administrativ.</p> <p>Organizimi i seancave dëgjimore.</p> <p>Përgatitje aktesh paraprake dhe përfundimtare.</p> <p>Pjesëmarrje dhe organizim i trajnimeve, sipas tematikave të mbrojtjes së të dhënave personale me kontrollues të ndryshëm publikë dhe privatë.</p>	<p>Gjatë vitit.</p>	<p>Ankesa të trajtuara.</p> <p>Vendime.</p> <p>Rekomandime.</p> <p>Urdhra.</p> <p>Seminare.</p>
<p>Trajtimi me efektivitet dhe transparencë i ankesave në një kohë sa me të shkurtër.</p>	<p>Orientimi i subjekteve mbi veprimet dhe mënyrat që duhet të ndjekin me qëllim ushtrimin e të drejtave të tyre.</p> <p>Ndërgjegjësimi i subjekteve të ligjit.</p> <p>Hetim i plotë administrativ në lidhje me ankesat, në rast domosdoshmërie për verifikime të mëtejshme pranë kontrolluesve.</p> <p>Përgjigje, informimi i ankuesit mbi rezultatet e hetimeve administrative.</p>	<p>Gjatë vitit.</p>	<p>Vënia në vend e së drejtës së shkelur të subjektit.</p> <p>Zbatimi i detyrimeve të përcaktuara në ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, në lidhje me trajtimin e ankesave.</p> <p>Ushtrimi i funksionit mbikëqyrës i Zyrës së Komisionerit në zbatim të ligjit.</p>

	Të dhëna statistikore në lidhje me ankesat dhe llojin e shkeljeve, sipas kontrolluesve dhe shqetësimeve të subjekteve.		
Regjistrimi i Kontrolluesve subjekt të ligjit nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Regjistrimi i Kontrolluesve, subjekt të ligjit nr.19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”.	Identifikim i kontrolluesve që nuk kanë njoftuar. Regjistri i subjekteve të ligjit për masat shtesë të sigurisë.	Gjatë vitit.	Transparencë ndaj publikut. Mundësia që i jepet publikut për t’u informuar se kush përpunon të dhëna personale, si dhe detaje të tjera të procesit. Zbatim i nenit 21, e në vijim i ligjit nr.9887/2008 dhe zbatim i pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr.19/2016.
Zhvillimi mbi plan tematik i procesit të monitorimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, duke synuar minimizimin e shkeljeve të ligjit, respektimin e privatësisë dhe përpunimin e drejtë e të ligjshëm të të dhënave personale. Hetime administrative tek kontrolluesit të cilët ofrojnë shërbime të ndryshme.	Identifikim i sektorëve të rëndësishëm për t’u kontrolluar. Përgatitja e planit për kontrollet që do të ushtrohen sipas sektorëve të fokusuar. Identifikimi i grupeve të punës.	Gjatë vitit.	Rritje ose thellimi i hetimeve dhe investigimeve të plota administrative, mbi bazë plani, ankese dhe njoftimi.
Hetime administrative në sektorin publik në lidhje me detyrimin për informim sipas nenit18, të ligjit nr.9887/2008, i ndryshuar.	Përgatitja e informacioneve paraprake në lidhje me veprimtaritë specifike të kontrolluesve. Përgatitja e akteve për ushtrimin e kontrollit.	Janar – Prill 2019.	Vendime. Rekomandime.

	Identifikimi i grupeve të punës.		Urdhra.
Hetime administrative të kontrolluesve që përpunojnë një numër të konsiderueshëm të dhënash personale dhe aktivitete të veçanta përpunimi, si: - Policia e Shtetit (sistemi TIMS). - Shërbimet e shoqërisë së informacionit. - Sektori i shërbimeve aeroportuale, etj.	Përgatitja e informacioneve paraprake në lidhje me veprimtaritë specifike të kontrolluesve. Përgatitja e akteve për ushtrimin e kontrollit. Identifikimi i grupeve të punës	Janar –Qershor 2019.	Vendime. Rekomandime. Urdhra.
Hetime administrative në kontrolluesit Subjekte Financiare Jobankare që ofrojnë shërbime postare.	Përgatitja e informacioneve paraprake në lidhje me veprimtaritë specifike të kontrolluesve. Përgatitja e akteve për ushtrimin e kontrollit. Identifikimi i grupeve të punës.	Janar –Qershor 2019.	Vendime. Rekomandime. Urdhra.
Verifikimi i zbatimit të Rekomandimeve/Urdhrave	Evidentimi i kontrolluesve për të cilët është dalë me Rekomandim/Urdhër. Verifikimi i zbatimit të Rekomandimeve të dhëna në vitin 2017/2018.	Korrik- Dhjetor 2019.	Vendime. Rekomandime. Urdhra.
Trajtimi i praktikave për transferimet ndërkombëtare	Identifikim i kontrolluesve që kryejnë transferim ndërkombëtar. Trajtim i praktikave të transferimit mbi kërkesën e kontrolluesve.	Gjatë vitit.	Vendime për dhënie/mosdhënie autorizimi ose orientime në lidhje me përmbushjen e detyrimeve ligjore. Garantimi i mbrojtjes së lirisë themelore për privatësi dhe përpunimi i

	<p>Identifikimi i subjekteve që realizojnë transferim ndërkombëtar (zyra përfaqësimi) dhe realizimi i hetimeve administrative në këta kontrollues.</p>		<p>ligjshëm i të dhënave personale gjatë transferimit ndërkombëtar.</p> <p>Garantimi që të drejtat e subjekteve të të dhënave të vazhdojnë të mbrohen edhe në rastet kur të dhënat personale të tyre të përpunohen jashtë territorit ku garantohet një nivel i mjaftueshëm i mbrojtjes së të dhënave.</p> <p>Zbatimi i neneve 8 dhe 9 të ligjit nr.9887/2008, i ndryshuar.</p>
--	--	--	--

ÇËSHTJET JURIDIKE

OBJEKTIVI	MASAT E PËRGJITHSHME	PERIUDHA	PRODUKTI
<p>Zhvillimi i kuadrit ligjor duke përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Harmonizim dhe përjasjen të ligjit nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar me Rregulloren e BE-së 679/2016 dhe Direktivën 680/2016. - Amendimi i ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”. - Hartimi i projektligjit “Mbi ripërdorimin e informacionit të 	<p>Studimi dhe analiza e akteve komunitare në përshtatje me legjislacionin kombëtar.</p> <p>Asistencë nga ekspertë ndërkombëtar të projektit IPA II 2017 për përgatitjen e amendimeve ligjore dhe nënligjore.</p> <p>Hartimi i amendimeve ligjore, relacionit shoqërues dhe tabelës së përputhshmërisë.</p> <p>Vlerësimi dhe ndryshim i kuadrit nënligjor.</p> <p>Ndërgjegjësim nëpërmjet organizimit të trajnimeve dhe tryezave për diskutim në lidhje</p>	<p>Gjatë vitit.</p>	<p>Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.</p> <p>Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.</p> <p>Projektligj “Mbi ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”.</p>

<p>sektorit publik” dhe përafrimi me Direktivën 2013/37/BE.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Amendimi i ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik. - Vijimi i procedurave për nënshkrimin e Konventës 108+. - Aderimi në Konventën 205/2009 e Këshillit të Evropës “Mbi aksesin në dokumentet zyrtare”. 	<p>me impaktin e GDPR-së në kontrollues publik dhe privatë.</p> <p>Hartimi i projektligjit si dhe konsultimi dhe njoftimi publik.</p>		<p>Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik.</p> <p>Projektakt “Për krijimin dhe e Regjistrin të Thirrjeve / Komunikimeve të Pakërkuara”.</p> <p>Ndryshimi i Udhëzimit nr.15, datë 23.12.2011“Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor”.</p> <p>Nënshkrimi i Konventës 108 +.</p> <p>Projektligj “Mbi aderimin në Konventën 205/2009 e Këshillit të Evropës “Mbi aksesin në dokumentet zyrtare”.</p>
<p>Rritje e ekspertizës dhe opinioneve ligjore për projekt akte ligjore dhe nënligjore të ardhura për mendim.</p>	<p>Përgatitje e mendimeve dhe opinioneve ligjore.</p> <p>Monitorim i fletoreve zyrtare.</p>	<p>Gjatë vitit.</p>	<p>Legjislacion i përafuar me fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.</p>

<p>Përgatitja e raportimeve periodike.</p>	<p>Pjesëmarrje dhe raportim i rregullt në Grupin Ndërinstitucional të Punës lidhur me: Kapitullin 23. Planit Kombëtar të Integritimit Evropian, në Nënkomitet si dhe Raportin e Shtetit, etj.</p> <p>Raportime mbi veprimtarinë institucionale në Kuvendin e Shqipërisë duke dërguar 12 raportime mujore dhe një Raport Vjetor.</p> <p>Analizë e Rezolutës së Kuvendit si dhe e Raportit të Shtetit (Progres Raportit).</p>	<p>Gjatë vitit.</p> <p>Çdo muaj.</p> <p>Dhjetor 2019.</p> <p>Mars 2019.</p>	<p>Performanca institucionale në kuadër të rekomandimeve të lëna.</p> <p>Zbatim i rekomandimeve të lëna nga këto dokumente.</p>
<p>Zbatimi i detyrimit parashikuar në ligjin nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, lidhur me trajtimin e ankesave.</p>	<p>Trajtim i ankesave.</p> <p>Kontakte me koordinatorët e fushës për ecurinë e ankesave.</p> <p>Zhvillimi i seancave dëgjimore.</p> <p>Bashkëpunim me shoqërinë civile.</p>	<p>Gjatë vitit.</p>	<p>Vendim.</p>
<p>Ndjekja e proceseve gjyqësore.</p>	<p>Ndjekja e çdo praktike nëpërmjet specialistit përkatës.</p> <p>Përgatitja e prapësimeve, autorizimeve dhe ankimimeve.</p> <p>Pjesëmarrje aktive në procese gjyqësore në datën dhe orën e caktuar.</p>	<p>Gjatë vitit.</p>	<p>Tabelë e përditësuar për ecurinë e proceseve gjyqësore.</p> <p>Kërkesa.</p> <p>Autorizime.</p> <p>Prapësime, ankimime, etj.</p>

Ndjekja e procedurave me zyrën përmbartimore.	Përgatitja e kërkesave lidhur me ekzekutimin e vendimeve të Komisionerit ose vendimeve gjyqësore.. Mbajtja e korrespondencës me zyrën përmbartimore.	Gjatë vitit.	Përditësimi i listës, mbi ekzekutimin e vendimeve me sanksion. Kërkesa ekzekutimi/pushimi, kontratë shërbimi.
Këshillim juridik me gjithë komponentët e drejtorive.	Ndjekje dhe zhvillim i procedurave të brendshme administrative. Dhënia e mendimeve profesionale në çdo vendimmarrje institucionale përpara miratimit. Finalizim i çdo akti të brendshëm për miratim nga titullari.	Gjatë vitit.	Akte rregullative të brendshme.

KOMUNIKIMI DHE MARRËDHËNIET ME JASHTË

OBJEKTIVI	MASAT E PËRGJITHSHME	PERIUDHA	PRODUKTI
Aktiviteti për 28 Janarin 2019 – Dita e Mbrojtjes së të Dhënave Personale “Luaj dhe mëso – Happy Onlife”	Organizimi i aktivitetit në mjediset e shkollës 9-vjeçare “Kosova”.	Janar 2019.	Aktivitet ndërgjegjësuese me nxënës dhe mësues në 6 shkolla 9-vjeçare, për mbrojtjen e privatësisë, nëpërmjet iniciativës “Luaj dhe mëso – Happy Onlife”.
Edicioni i 3-të i Shkollës Dimërore “Informim dhe Privatësi” me Universitetin Epoka.	Korrespondencë dypalëshe. Organizimi i aktivitetit, përzgjedhja e tematikave dhe pjesëmarrësve.	Janar 2019.	Studentë dhe staf akademik /administrativ i trajnuar.

<p>Aktivite trajnuese të KDIMDP me Autoritete Publike dhe/ose “kontrollues”/“përpunues”.</p> <p>Vijimi i aktiviteteve informuese e sensibilizuese mbi edukimin e të rinjve për të drejtat dhe përgjegjësitë e përdorimit të të dhënave personale në ambientet digjitale.</p>	<p>Bashkëpunimi dhe mbështetja e strukturave të tjera të Zyrës së Komisionerit në organizimin e këtyre eventeve.</p> <p>Organizimi i aktiviteteve me të rinjtë mbi edukimin për përdorimin e të dhënave personale në ambientet digjitale.</p>	<p>Gjatë vitit.</p>	<p>Qytetarë, organizata të shoqërisë civile, media, të rinjtë etj., si dhe “kontrollues” e “përpunues” të informuar dhe ndërgjegjësuar për të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë dhe përpunimin e të dhënave në ambientet digjitale.</p>
<p>Informimi mbi veprimtarinë e KDIMDP.</p>	<p>Informimi i plotë i publikut duke shfrytëzuar të gjitha mjetet e komunikimit, sidomos bashkëveprim me median.</p>	<p>Gjatë vitit.</p>	<p>Njoftime për shtyp.</p> <p>Botimi /publikim i materialeve informuese dhe /ose ndërgjegjësuese.</p> <p>Botimi i revistës periodike 6-mujore (nr. 7 dhe 8).</p> <p>Faqe zyrtare e përditësuar.</p>
<p>Zhvillimi i trajnimeve për stafin në lidhje me terma reference specifike, në bashkëpunim me organizata partnere ndërkombëtare, përfshirë IAF-in, Taiex-in, etj.</p>	<p>Evidentim i nevojave për trajnim dhe rritje kapacitetesh dhe evidentim e koordinim i asistencës për zhvillimin e trajnimeve.</p>	<p>Gjatë vitit.</p>	<p>Staf i trajnuar dhe adresim i rekomandimeve në kuadër të procesit të anëtarësimit në BE.</p>
<p>Mbajtja, menaxhimi dhe intensifikimi i marrëdhënieve ndërkombëtare të KDIMDP.</p> <p>Përditësimi i bazës së të dhënave të akteve dhe dokumenteve ndërkombëtare si në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale</p>	<p>Komunikimi /korrespondencë me autoritetet homologe dhe shkëmbim informacioni për fushën e veprimtarisë institucionale.</p> <p>Përditësimi i të dhënave në faqen zyrtare.</p> <p>Pasurim me materiale i faqes zyrtare.</p> <p>Përkthime të dokumenteve dhe publikim i tyre.</p>	<p>Gjatë vitit.</p>	<p>Transparencë, informacion për shoqërinë në tërësi brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Garantim i të drejtës për Informim.</p> <p>Asistencë për punën e drejtorive të Zyrës së Komisionerit.</p>

dhe ashtu edhe të drejtës së informimit.			
<p>Marrëdhënie me organizatat në të cilat jemi të anëtarësuar.</p> <p>Vijimi i bashkëpunimit në kuadër të forumeve dhe organizmave ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të dhënave dhe të drejtës për informim, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Bordi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave. - Komiteti Konsultativ i Konventës 108 (Komiteti T-PD). - Grupi Ndërkombëtar i Punës për Mbrojtjen e të Dhënave në Telekomunikacione (Grupi i Berlinit). - Shoqata Frankofone e Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (AFAPDP). - Rrjeti i Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave të Evropës Qendrore dhe Lindore (CEEDPA). - Konferenca e Autoriteteve Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave. - Konferenca Ndërkombëtare e Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë (ICDPPC) dhe Komiteti Ekzekutiv. 	Komunikimi /bashkëpunimi me organizatat e ndryshme ndërkombëtare të fushës së veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit.	Gjatë vitit.	<p>Shkëmbim eksperience, informacioni, praktikash dhe forcim kapacitetesh.</p> <p>Raporte periodike.</p> <p>Opinione mbi akte të miratuara.</p>

<p>Konferenca Ndërkombëtare e Komisionerëve të Informimit (ICIC).</p> <p>- Forumin Digital ClearingHouse.</p>			
---	--	--	--

SHËRBIMET E BRENDSHME DHE FINANCA

OBJEKTIVI	MASAT E PËRGJITHSHME	PERIUDHA	PRODUKTI
<p>Funksionimi i strukturës së KDIMDP-së.</p>	<p>Publikimi i planit të pranimit në shërbimin civil për 2019.</p> <p>Ndjekja e procesit të rekrutimit në përputhje me ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”.</p> <p>Miradministrim i procesit të vlerësimit të performancës në punë.</p> <p>Vlerësimi periodik i punonjësve (me status të punonjësit civil/ ose në kohë prove) si dhe mbledhja dhe përpunimi i rezultateve për hartimin e raportit.</p> <p>Vlerësime individuale, konfirmim i nëpunësve dhe procedura disiplinore sipas rastit.</p> <p>Hartimi i propozimit për ndryshimin e strukturës së Zyrës së Komisionerit në rast shtese dhe ndjekja e procesit deri në miratimin e saj.</p>	<p>Janar – Mars 2019.</p> <p>Çdo 6 mujor.</p> <p>Gjatë vitit.</p>	<p>Strukturë e konsoliduar.</p> <p>6 punonjës të përkohshëm me kohë pune të reduktuar.</p> <p>Punonjës të vlerësuar.</p> <p>Strukturë e rikonceptuar.</p>

<p>Sistem i përmirësuar i kontrollit dhe menaxhimit financiar.</p>	<p>Koordinimi me çdo strukturë, për monitorimin në vazhdimësi të procesit të menaxhimit financiar.</p> <p>Marrja e masave në zbutjen e nivelit të rreziqeve gjatë veprimtarisë së strukturave.</p> <p>Miratimi i kalendarit të Dokumentit të PBA-së dhe hartimi 3-vjeçar i PBA.</p> <p>Evidentimi dhe reflektimi i kërkesave shtesë në fazën strategjike, gjatë nogocimit dhe mbrojtjes së buxhetit.</p> <p>Përdorimi i buxhetit mbi baza produkti.</p> <p>Analizë e kosto-përfitimit për çdo aktiviteti.</p> <p>Mbikëqyrja e finalizimit të procedurave të prokurimit për mbështetjen e aktiviteteve operacionale dhe prioritare.</p> <p>Efiçensë dhe transparencë gjatë ekzekutimit të buxhetit, nëpërmjet takimeve periodike të GMS (Grupi i Menaxhimit Strategjik) dhe dhënies së informacioneve në kohë për vendimmarrje.</p> <p>Raportim i të ardhurave të krijuara dhe shpenzimeve buxhetore të kryera të vitit.</p>	<p>Gjatë vitit.</p> <p>Mars-Prill 2019.</p> <p>Prill- Nëntor 2019.</p> <p>Çdo 4 muaj.</p> <p>Çdo 4 muaj</p>	<p>Sistem efektiv menaxhimi.</p> <p>Buxhet i siguar dhe i realizuar sipas prioriteteve.</p> <p>Raporte monitorimi.</p> <p>Raporte realizimi të procedurave të prokurimit.</p>

	Evidentim i risqeve dhe marrja e masave konkrete për reduktimin e tyre, në funksion të sigurimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit 2019.	Çdo 4 muaj. Gjatë vitit.	Raportime periodike.
Kualifikim i thelluar i kapaciteteve institucionale.	Hartim i planit të trajnimeve për zhvillimin e njohurive shtesë, me burime të brendshme dhe të jashtme. Pjesëmarrje aktive në trajnimet e ofruara nga ASPA dhe/ose organizata publike/jopublike apo të huaja. Krijimi i mundësive për pjesëmarrjen e stafit në ëorkshop/vizita studimore të organizuara jashtë vendit në fusha specifike me ndikim direkt në rritjen profesionale.	Gjatë vitit.	Staf i trajnuar në nivel profesional/statistika.
Infrastrukturë dhe Pajisje.	Ndjekja e procedurave të prokurimit të shpenzimeve kapitale (investime), për krijimin e kushteve optimale të punës. Pajisje me mjete kompjuterike dhe elektronike.	Gjatë vitit.	Ambiente me standarde. Raporte periodike. Raportime periodike.

	Analizë e risqeve të funksionimit të brendshëm të sistemeve të instaluara, në funksion të mirë administrimit, sigurisë së të dhënave dhe infrastrukturës.		
Zhvillim, transparencë dhe monitorim i faqes zyrtare.	<p>Përditësimi faqes zyrtare.</p> <p>Raportime javore nga çdo drejtori për materialet e përpunuara për publikim.</p> <p>Monitorimi dhe përditësimi i programit të transparencës.</p>	Gjatë vitit.	Faqe zyrtare e përditësuar.